

**UDHËZUES
PËR HARTIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN**

PASQYRA E LËNDËS

QËLLIMI I UDHËZUESIT	3
OBJEKTIVAT E PKIE	4
SHTRIRJA NË KOHË DHE AFATET E PKIE	5
KALENDARI I HARTIMIT DHE MIRATIMIT TË PKIE 2022 – 2024	6
PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE	6
CIKLI I PLANIT KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN	7
PUNA PËRGATITORE	8
- <i>Përditësimi i Udhëzuesit</i>	8
- <i>Dokumentat dhe burimet referuese</i>	8
- <i>Trajnimi</i>	9
ANALIZA E MANGËSIVE	9
- <i>Identifikimi i “acquis” dhe Kërkesave Kryesore</i>	9
- <i>Identifikimi i Kuadrit Kombëtar</i>	10
- <i>Vlerësimi i Mangësive</i>	11
PLANIFIKIMI.....	12
- <i>Përcaktimi i masave prioritare</i>	12
- <i>Përcaktimi i Kostove</i>	13
HARTIMI DHE KONTROLLI I CILËSISË	14
KONSULTIMI DHE MIRATIMI.....	14
- <i>Konsultimi me Aktoret Jo-shtetëror</i>	14
- <i>Miratimi</i>	15
- <i>Konsultimi i projektakteve me shërbimet e Komisionit Evropian</i>	15
MONITORIMI, RAPORTIMI DHE VLERËSIMI	17
- <i>Monitorimi</i>	17
- <i>Raportimi</i>	18
- <i>Vlerësimi</i>	18
STRUKTURA E PËRGJITHSHME E PLANIT KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN	19
HYRJA.....	19
KRITERI POLITIK	19
AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT NË BE.....	21
STRUKTURA E PJESËS NARRATIVE TË KAPITUJVE NEGOCIUES.....	23
TABELA E DOKUMENTEVE STRATEGJIKE PËR TU MIRATUAR.....	25
TABELA E AKTEVE LIGJORE PËR T’U MIRATUAR.....	25
TABELA E MASAVE ZBATUESE	26
PËRLLOGARITJA E KOSTOS (UDHËZIME).....	28

QËLLIMI I UDHËZUESIT

Udhëzuesi mbi hartimin dhe zbatimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian ka si qëllim të sigurojë udhëzime praktike për nëpunësit civilë dhe punonjësit e tjerë publikë që marrin pjesë në Planifikimin, Hartimin, Zbatimin, Monitorimin, Raportimin dhe Vlerësimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE).

PKIE përgatitet në zbatim të nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, i cili përcakton detyrimin për "përafrimin e legjislacionit ekzistues të Shqipërisë me atë të Komunitetit dhe zbatimin efektiv të tij" dhe se "Përafrimi do të bëhet në bazë të një programi për t'u rënë dakord midis Komisionit të Komuniteteve Evropiane dhe Shqipërisë". Udhëzuesi është një dokument publik, i mundësuar për informim të gjithë aktorëve jo shtetërorë të angazhuar në tryezat e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE).

Shqipëria aplikoi për anëtarësim në Bashkimin Evropian në prill 2009 dhe mori statusin e vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian në qershor 2014. Nën kuadrin e këtij zhvillimi në procesin e Integritimit Evropian të Shqipërisë, Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA), i përgatitur në mënyrë të përvitshme nga viti 2004, u rikonceptua në strukturën e një plani Kombëtar për Zbatimin e "acquis", dhe nga viti 2014, Republika e Shqipërisë miraton në mënyrë të përvitshme përditësimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, i cili mbulon një periudhë 3 vjecare.

Më datë 26 mars 2020, Këshilli Evropian miratoi konkluzionet e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të datës 25 mars 2020 për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë, përfshirë miratimin e metodologjisë së re të negociatave të anëtarësimit. Metodologjia e re bazohet në një përfaqje më dinamike, më të parashikueshme duke e bërë procesin më të besueshëm dhe me një drejtim më të fortë politik. Procesi i negociatave të anëtarësimit do të bazohet në kapitujt negociues të organizuar në pesë grupe tematike. Grupi i parë tematik 'Themelorët' do të kushtëzojë ecurinë në grupkapitujt e tjerë negociues.

Në këtë fazë të procesit të hapjes së negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian është e nevojshme që PKIE, si plani kombëtar i procesit të integritimit në BE, të reflektojë fazën e hapjes së negociatave për anëtarësim, duke prioritetizuar detyrimet parësore që rrjedhin nga procesi i negociatave të anëtarësimit në BE, sikurse kërkohet sot e në vijim nga Komisioni Evropian, duke përfshirë mekanizmat e ndryshëm të stabilizim-asociimit.

Si një vend kandidat që synon të nisë dhe zhvillojë negociatat e pranimit, Shqipëria vijon të jetë e angazhuar të adoptojë dhe zbatojë "acquis" e BE, detyrim që buron nga MSA. Realizimi i këtij synimi kërkon instrumente dhe mjete të përmirësuara për Planifikimin, Zbatimin, Monitorimin, Raportimin dhe Vlerësimin e zbatimit të "acquis".

Ky udhëzim mbështetet dhe ushqehet nga eksperiencia e akumuluar nga administrata që nga krijimi i PKZMSA si dhe nevoja për ta modernizuar PKIE duke e bërë atë pjesë integrale të proceseve planifikuesë të zhvillimit ekonomik dhe social të përcaktuara në Sistemin e Planifikimit Strategjik (IPS).

Ky udhëzim mbështetet gjithashtu në “*Better Regulation Guidelines*” të Komisionit Evropian¹.

Ky udhëzim shpjegon objektivat e PKIE, strukturën dhe përmbajtjen e tij, procedurën për hartimin, miratimin dhe monitorimin, si dhe rolin e institucioneve, njësisve brenda tyre dhe organeve të përfshira në proces.

OBJEKTIVAT E PKIE

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian është një dokument kombëtar që pasqyron planifikimin për një periudhë 3 vjecare të: politikave, kuadrit ligjor dhe administrativ, masave zbatuese dhe infrastrukturore, si dhe burimeve finaciare të nevojshme që Shqipëria të zbatojë politikat, legjislacionin dhe standardet e BE. Në një kuptim më të gjerë, PKIE është një udhërrëfyes i reformave të nevojshme për procesin e anëtarësimit në BE.

Objektivat e PKIE janë:

- Planifikimi i transpozimit dhe zbatimit të “acquis” së BE -së në Shqipëri në zbatim të MSA dhe proceseve të tjera të lidhura me integrimin Evropian;
- Përcaktimi i përparësive në reformat kombëtare të lidhura me politikat e BE-së;
- Paraqitja e një baze ligjore, administrative dhe institucionale për përgatitjen për negociatat e aderimit;
- Sigurimi i qëndrueshmërisë së strategjive dhe politikave kombëtare me masat që synojnë zbatimin e “acquis” së BE -së;
- Identifikimi i nevojave dhe përshtatja sipas strukturës qeverisëse vendase në ndërtimin institucional për zbatimin e “acquis” së BE -së;
- Të shërbejë si bazë për planifikimin e fondeve kombëtare dhe ndihmës së huaj për të mbështetur prioritetet e reformave të lidhura me BE-në.

Kërkesat kryesore për përgatitjen dhe zbatimin e PKIE janë:

- Kuptimi dhe detajimi në masa konkrete i kërkesave të përcaktuara në “acquis” të BE -së;
- Angazhimi në konvergjinë e reformave kombëtare me politikat e BE;
- Angazhimi në ngritjen e kapaciteteve njerëzore, administrative dhe institucionale të institucioneve shtetërore kombëtare;
- Bashkëpunimi ndër-institucional;
- Zbatimi rigoroz i mjeteve dhe procedurave të përcaktuara për Planifikimin, Hartimin/Përditësimin, Zbatimin, Monitorimin, Raportimin dhe Vlerësimin e PKIE;
- Konsultimi i aktorëve jo-shtetëror në procesin e përgatitjes së PKIE;
- Ruajtja e kujtesës institucionale mbi historikun e procesit.

¹ Better Regulation Guidelines, Brussels, SĚD (2017) 350, 7 July 2017 - [https://ec.europa.eu/transparency/documents-register/detail?ref=SĚD\(2017\)350&lang=en](https://ec.europa.eu/transparency/documents-register/detail?ref=SĚD(2017)350&lang=en)

SHTRIRJA NË KOHË DHE AFATET E PKIE

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian, si një dokument që synon adoptimin dhe zbatimin e plotë të “acquis”, pavarësisht periudhës kohore të planifikimit, duhet të përgatitet duke mbajtur parasysh këtë synim.

Në terma më të matshëm, fokusi i PKIE është në masat afatshkurtra (1-2 vjet) dhe afatmesme (3-5 vjet), të cilat parashikohen për tu miratuar dhe zbatuar. Këto masa duhet të përfshijnë gjithashtu aktivitete përgatitore për masat që janë planifikuar për periudhën e mëvonshme, ose të paktën datën e fillimit të aktiviteteve të planifikuara për periudhën e mëvonshme.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2022 – 2024 do të përfshijë masat që janë parashikuar të zbatohen gjatë periudhës 1 janar 2022 deri më 31 dhjetor 2024.

PKIE rishikohet çdo vit, duke pasqyruar prioritetet dhe rekomandimet e reja që do të jepen nga Komisioni Evropian gjatë periudhës para planifikimit, si dhe planifikimin e prapambetur sërish.

Afatet e miratimit të masave ligjore dhe realizimit të masave zbatuese të përfshira në PKIE 2022 – 2024 do të jenë mbi baza tremujori, të ndara në tre vite planifikimi.

Gjatë përcaktimit të afateve të miratimit të masave ligjore duhet të kihen parasysh:

- priorizimi sipas rekomandimeve të Komisionit në mekanizmat e stabilizim-asociimit/ raportet vjetore/ raportet *screening*, analizat e mangësive ligjore, etj.;
- përputhshmëria me objektivat strategjike të shtetit dhe planifikimi në programin afatmesëm buxhetor;
- kapacitetet për hartimin dhe miratimin e aktit të veçantë ligjor, si dhe instrumentave që shërbejnë për të mundësuar vlerësimin e përputhshmërisë së tij me *acquis* përkatëse;
- kërkesa ligjore për paraqitjen e projektaktit për konsultim publik në përputhje me Ligjin për konsultimin publik, ose në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 113, datë 30.08.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian”;
- procedurat e përfunduara në lidhje me vlerësimin e ndikimit rregullator;
- konsultimi i mundshëm i projektaktit me shërbimet e Komisionit Evropian;
- koha e nevojshme për shqyrtimin dhe miratimin e projektligjeve nga Kuvendi i Shqipërisë.

Gjatë përcaktimit të afateve për masat zbatuese të përfshira në PKIE duhet të kihen parasysh kapacitetet administrative për koordinimin dhe zbatimin e këtyre aktiviteteve, përputhja e afateve të realizimit të këtyre aktiviteteve me afatet e miratimit të projektakteve, etj.

Kalendari i hartimit dhe miratimit të PKIE 2022 – 2024

Puna përgatitore		
Inicimi i procesit të hartimit të PKIE 2022 – 2024	Kryenegociatori dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Shtator 2021
Hartimi i metodologjisë së PKIE 2022 – 2024	Kryenegociatori dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Shtator 2021
Miratimi i metodologjisë së PKIE 2022 – 2024	Grupi Negociator	Tetor 2021
Analiza e zbatimit të PKIE 2021 – 2023	Grupet ndërinstitucionale të punës	Tetor 2021
Hartimi		
Hartimi i versionit shqip/anglisht të PKIE 2022 – 2024	Grupet ndërinstitucionale të punës	Deri me 5 nëntor 2021
Kontrolli i versionit shqip/anglisht të PKIE 2022 – 2024	Kryenegociatori dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Deri me 15 nëntor 2021
Finalizimi i versionit shqip/anglisht të PKIE 2022 – 2024	Grupet ndërinstitucionale të punës	Deri me 25 nëntor 2021
Konsultimi publik i PKIE 2022 – 2024	Kryenegociatori dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Dhjetor 2021
Miratimi i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2022 – 2024	Grupi Negociator dhe Këshilli i Ministrave	Janar 2022
Dërgimi i PKIE 2022 – 2024 tek Kuvendi i Shqipërisë	Kryenegociatori	Janar 2021
Dërgimi i PKIE 2022 – 2024 tek shërbimet e Komisionit Evropian	Kryenegociatori	Janar 2021

PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE

Sikurse përcaktuar në Nenin 100 të Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Ministrave përcakton drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore. Ligji Nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” përcakton rregullat bazë për shqyrtimin e projektakteve ligjore nga Këshilli i Ministrave.

Në këtë kuadër, Këshilli i Ministrave është përgjegjës për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian duke pasur parasysh rëndësinë e këtij Plani për përshtatjen e politikave shtetërore dhe legjislacionit kombëtar me *acquis* dhe standardet e BE-së sipas prioritizimit në dokumentat strategjike vendase, si dhe mbikëqyr në nivelin më të lartë politik vendas zbatimin e tij nga të gjitha institucionet shtetërore.

Përgjegjësitë dhe funksionet përkatëse të institucioneve të tjera shtetërore për Planifikimin, Hartimin/Përditësimin, Zbatimin, Monitorimin, Raportimin dhe Vlerësimin e PKIE, përcaktohen në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 749, datë 19.12.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse, për zhvillimin e


negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian” si dhe akteve të tjera të miratuara në zbatim të tij.

CIKLI I PLANIT KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

Cikli vjetor i PKIE përbëhet nga këto procese:

- Puna përgatitore;
- Analiza e mangësive;
- Planifikimi;
- Hartimi dhe kontrolli i cilësisë;
- Konsultimi dhe miratimi;
- Monitorimi, raportimi, dhe vlerësimi.

Figura: Lidhja mes proceseve të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian



Puna përgatitore

- Përditësimi i Udhëzuesit

Mbështetur në analizën e zbatimit të PKIE në proces përditësimi, zhvillimet në procesin e integritimit Evropian, dhe reformat me prioritet kombëtar, MEPJ përditëson udhëzuesin / metodologjinë e PKIE.

Përditësimi i udhëzuesit lidhet me:

- Vendosijen e objektivit specifik të përditësimit vjetor;
- Qartësimin e mjeteve dhe instrumenteve të përdorura për zbatimin e këtij udhëzuesi.

Përditësimi bëhet në bazë të mësimave të nxjerra dhe reagimeve nga institucionet pjesëmarrëse dhe palët e interesuara gjatë vitit të kaluar.

- Dokumentat dhe burimet referuese

Objektivi kryesor i PKIE 2022-2024 është të mbështesë zbatimin e MSA-së dhe përgatitjet e institucioneve shqiptare për negociatat e ardhshme të pranimit.

Në përcaktimin e masave prioritare në PKIE, institucionet përkatëse **duhen të kenë në vëmendje** këto dokumenta dhe burime:

1. “Acquis” të BE -së sipas ndarjes në kapitujt përkatës;
2. Informacioni i marrë gjatë takimeve shpjeguese të legjislacionit të BE sipas kapitujve negociues, acquis e re e përcjellë nga Komisioni Evropian dhe rezultatet paraprake të analizës “screening” të mangësive ligjore/ administrative/ institucionale për çdo kapitull negociues;
3. Rekomandimet e dhëna nga shërbimet e Komisionit Evropian në Raportin vjetor më të fundit për Shqipërinë dhe takimet e mekanizmave të përbashkëta të ngritura në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
4. Rezultatet nga monitorimi kombëtar i procesit dhe raportet e paraqitura tek autoritetet kombëtare dhe KE;
5. Raportet e organizatave ndërkombëtare të tilla si OKB, BB, etj., mbi vlerësimin e reformave social-ekonomike;
6. Raportet e vlerësimit e projekteve të asistencës teknike në kuadër të programit IPA apo të financuara nga donatorë të tjerë;
7. Programin e përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit të parë të planifikimit;
8. Programin Buxhetor Afatmesëm aktual;
9. Programin e Reformave Ekonomike të fundit të miratuar;
10. Dokumentat e programimit të Programit “Instrumentat e Para-Aderimit” (IPA III).

PKIE do të shërbejë si bazë edhe për hartimin e planit vjetor të përkthimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe. Përkthimi i legjislacionit evropian në gjuhën shqipe

është i nevojshëm si hapi paraprak për përafrimin e legjislacionit, por edhe si një nga kushtet e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

- Trajnimi

Procesi i përditësimit të PKIE fillon me një sesion trajnimi të organizuar nga MEPJ, me pjesëmarrjen e strukturave përgjegjëse për kapitujt.

MEPJ organizon trajnime sistematike për punonjësit publikë që do të marrin pjesë në hartimin dhe monitorimin e PKIE. Programi i trajnimit përditësohet çdo vit, bazuar në objektivin dhe nevojat specifike që janë përcaktuar.

Analiza e Mangësive

Analiza e mangësive / përditësimi i analizës së mangësive është një nga proceset kryesore për hartimin e PKIE. Kjo analizë synon të përcaktojë hendekun ndërmjet situatës aktuale me situatën e synuar.

Duke konsideruar që situata e synuar është anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në BE, e cila mund të matet përmes adoptimit dhe zbatimit të “acquis”, niveli i përafrimit dhe analizimi i zbatimit të saj do të përbënte dhe pjesën thelbësore të kësaj analize.

Procesi i vlerësimit të nivelit të përafrimit dhe zbatimit të “acquis” (Analiza e Mangësive) përbëhet nga hapat e mëposhtëm:

1. Identifikimi i “acquis”;
2. Njohja e detyrimeve kryesore të BE -së që rrjedhin nga “acquis” për kapitullin / nën-kapitullin;
3. Identifikimi i dokumenteve të politikave dhe legjislacionit kombëtar që rregullojnë sektorin/ fushën përkatëse të “acquis”;
4. Identifikimi i institucioneve përgjegjëse, funksionet dhe kapacitetet e tyre;
5. Krahasimi i kërkesave të “acquis” kundrejt politikës kombëtare, kuadrit legjislativ dhe institucional dhe identifikimi i boshllëqeve të politikave, legjislative dhe institucionale.

Për qëllimet e hartimit të PKIE, analiza e mangësive bëhet në nivelin e nën-titullit (nën-kapitullin). Njësia teknike (drejtoria/sektori) i institucionit (eve) përgjegjëse për nën-titullin është përgjegjës për analizën e mangësive.

- Identifikimi i “acquis” dhe Kërkesave Kryesore

Për të identifikuar “acquis” dhe kërkesat kryesore që rrjedhin prej saj në funksion të analizës së mangësive, njësitë përkatëse të institucioneve përbërëse të secilit GNPIE, duhet të shqyrtojnë:

1. Detyrimet e paplotësuara në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit;
2. Listën e acquis të ofruar/shpjeguar nga Komisioni i BE -së për atë kapitull gjatë Shqyrtimit Shpjegues (“*explanatory screening*”);

3. Punën e kryer tashmë nga GNPIE-ja për Vlerësimin e Mangësive Ligjore (LGA) dhe Vlerësimin e Mangësive Institucionale dhe Administrative (IAGA) për kapitullin përkatës, në bashkëpunim të ngushtë me sekretariatën e saj dhe Institucionet përbërëse të saj;
4. “acquis”/rekomandimet e reja të identifikuar/ofruara gjatë nën-komiteteve përkatëse të MSA-së, relevante për ato kapituj;
5. Rekomandimet/gjetjet në Raportin Vjetor të Komisionit Evropian;
6. Planet ekzistuese për kapitullin (nën kapitujt) përkatës në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian për 2021-2023 (PKIE).dhe /ose strategjite sektoriale?

Në analizimin e “acquis”, është thelbësore të njihen kërkesat kryesore që rrjedhin prej tij, ndaj mund të përdoren edhe burimet e tjera të disponueshme të BE -së, të tilla si: përmbledhje aktesh; udhëzime; doracakë; dokumentet e politikave që i paraprijnë miratimit të masës; relacione shpjeguese; materialet e Shteteve Anëtare të BE; etj.

Analiza e hollësishme e kërkesave të “acquis” bëhet në nivelin e masës së BE -së, nga sektorët teknikë përgjegjës për masën, përfshirë personat e emëruar si përgjegjës për masën e BE -së. Në vijim, institucionet përgjegjëse për nën-titullin përmbledhin/bashkojnë kërkesat e identifikuar në nivelin e nën-titullit. Në këtë analizë merren parasysh edhe çështjet ndërsektoriale si dhe objektivat e përgjithshme të politikave të përcaktuara.

- Identifikimi i Kuadrit Kombëtar

Në identifikimin e Kuadrit Kombëtar përkatës të fushës që rregullon nën-titulli (nën kapitulli i acquis), shqyrtohet: kuadri ekzistues i politikave; legjislacioni parësor dhe dytësor; dhe kuadri institucional dhe administrativ.

Kuadri i politikave – përfshin dokumente ombrellë të tilla si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim , si dhe strategjitë sektoriale dhe dokumentet e tjera të politikave në zbatim të tyre.

Kur analizohet legjislacioni kombëtar ekzistues, merret parasysh jo vetëm legjislacioni sektorial, por edhe legjislacioni përkatës horizontal. Kuadri ligjor kombëtar analizohet nën dritën e kërkesave të “acquis” duke marrë në konsideratë: nëse ato ekzistojnë në legjislacionin kombëtar; nëse legjislacioni kombëtar bie ndesh me to/nuk ekziston; ose ato janë të përafuara në një shkallë të caktuar.

Në identifikimin dhe analizën e kuadrit institucional dhe administrativ duhet të përfshihen të gjitha institucionet përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e akteve kombëtare që transpozojnë “acquis” në Shqipëri. Roli i tyre në lidhje me “acquis” duhet të analizohet duke marrë parasysh funksionet specifike që ata kryejnë brenda sistemit ligjor kombëtar. Këto funksione mund të jenë ato të: hartimit të politikave dhe hartimit të legjislacionit; rregullatorit dhe mbikëqyrjes; kontrollit dhe inspektimit; zbatimit, investimeve, administrimit të infrastrukturës; ofrimit të shërbimeve, etj.

Në analizën e kuadrit administrative është i rëndësishëm vlerësimi i kapacitetit të institucioneve/njësive përgjegjëse për të adoptuar dhe zbatuar “acquis”, veçanërisht sa vijon:

- Ekzistenca e strukturave të përshtatshme administrative;
- Numri i punonjësve publikë për funksionin përkatës;
- Njohuritë dhe aftësitë për të adoptuar dhe zbatuar “acquis”;
- Ekzistenca e strukturave/sistemeve/mjeteve/procedurave/metodave për zhvillim/zbatim, bashkëpunim ndërinstitucional, transparencë, pjesëmarrje publike etj.;
- Cilësia e shërbimeve të ofruara;
- Burimet teknike.

- Vlerësimi i Mangësive

Bazuar në analizën e kërkesave të BE-së dhe kuadrit kombëtar aktual, institucioni përgjegjës përbërës i GNPIE përkatëse për atë kapitull (drejtoria teknike përkatëse për nën-kapitullin) vlerëson mangësitë ndërmjet tyre duke marrë për bazë reference “acquis” dhe kërkesat respektive për atë nën-kapitull.

Gjatë këtij procesi, është thelbësore të sigurohet përputhshmëria e PKIE me dokumentet e tjera kombëtare. Për këtë qëllim, institucionet përgjegjëse identifikojnë ndryshimet që kërkesat e “acquis” mund të shkaktojnë në politikën kombëtare, kuadrin ligjor dhe instrumentet e tjera, si dhe identifikojnë situata konfliktuale që duhet të adresohen. Nëse analiza e mësipërme tregon se nevojiten ndryshime të mëdha në situatën aktuale, këto diskutohen në sektorët teknikë përgjegjës, dhe nëse përfshihen më shumë sektorë/ministri, ato diskutohen në nën - Grupin GNPIE përkatës për vendimarrje.

Në nivelin legjislativ, përcaktohet nevoja për adoptimin e “acquis” / përfshirjen e kërkesave të BE -së në drejtim të miratimit të dispozitave të reja ligjore, ndryshimit ose shfuqizimit të atyre ekzistuese. Ministrinë propozuese të masave legjislative të parashikuara në PKIE kryejnë edhe një analizë të shkallës së përafritimit të legjislacionit të propozuar me atë evropian që synohet të përafrohet. Si pjesë e këtij procesi janë përgatitur ose analizuar edhe tabelat e përputhshmërisë për akte të veçanta të legjislacionit të Bashkimit Evropian. Tabelat e përputhshmërisë japin një analizë shumë të detajuar krahasuese të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian në nivelin e aktit të veçanta. Analiza e përafritimit, nga ana tjetër, ofron një vlerësim më të përgjithshëm në nivelin e parimeve të përgjithshme dhe normave kryesore (d.m.th. të drejtave dhe detyrimeve) të legjislacionit të Bashkimit Evropian duke vlerësuar nëse të njëjtat parime dhe norma ekzistojnë edhe në legjislacionin shqiptar.

Vlerësimi i Ndikimit Rregullator (RIA) për transpozimin e masave të BE -së duhet të adresohet brenda qasjes së përgjithshme të Qeverisë, dhe ai shërben si bazë për të përcaktuar shpejtësinë më të cilën parashikohet adoptimi dhe zbatimi i “acquis”. Gjatë procesit të analizës, ministrinë dhe institucionet qendrore këshillohen që të përdorin sa më shumë që të jetë e mundur raportet e vlerësimit të ndikimit (*impact assessment report*), përfshirë shfrytëzimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit të Komisionit Evropian. Këto raporte paraqesin informacionin kryesor të gjeneruar nga procesi i vlerësimit të ndikimit rregullator. Në këto raporte bëhet e qartë se cili është ndikimi i aktit, cili ndikohet dhe si. Këto raporte trajtojnë edhe çështje të tilla si

subsidiariteti, proporcionaliteti, qëndrueshmëria, mjedisi, impakti social dhe ndikimet ekonomike (duke përfshirë ndikimin në konkurrueshmëri dhe në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme).

Kur vlerësohet kapaciteti institucional i institucioneve përkatëse kombëtare për transpozimin dhe zbatimin e “acquis”, është e rëndësishme të identifikohen se cilat funksione të reja ose të modifikuara duhet të kryejnë institucionet, në mënyrë që të jenë në gjendje të planifikojnë masat e duhura.

Planifikimi

Faza e fundit para procesit të Hartimit të PKIE është Planifikimi i masave prioritare afat shkurtër dhe afat mesme, për adoptimin dhe zbatimin e “acquis”.

- Përcaktimi i masave prioritare

Bazuar në analizën e mangësive, struktura përgjegjëse / sektori teknik i Ministrisë /Institucionit Shtetëror planifikon / përcakton kuadrin e politikave prioritare: objektivat dhe instrumentet kryesore të politikës, duke marrë parasysh ndikimin e pritshëm të reformës.

Masat e politikave të identifikuara në PKIE duhet të kontrollohen në detaje për përputhshmërinë me kuadrin strategjik kombëtar në fuqi, dhe instrumentet e tjera të politikave që përbëjnë masat e politikave kombëtare. Nëse identifikohet mospërputhje, çështja ngrihet dhe trajtohet në nivelin e nëngrupit GNPIE dhe në nivel politik (ministër përgjegjës). Nëse dokumentet aktuale të politikave nuk mbulojnë periudhën afatmesme, planifikohet përpunimi i dokumenteve të reja përkatëse të politikave-afatshkurtra dhe afatmesme. Përpunimi i një dokumenti të ri politik duhet të përfshihet dhe të jetë në përputhje me planet strategjike të Qeverisë/planet operative të ministrisë/institucionit.

Përcaktimi i masave prioritare kombëtare (legjislative, institucionale apo zbatuese), planifikohet në përputhje me objektivat e politikave kombëtare ku ato mbështeten duke siguruar harmoninë me prioritetet e përcaktuara në dokumentat e shqyrtuar gjatë analizës së mangësive (Shiko nën kreun “Identifikimi i “acquis” dhe Kërkesave Kryesore”.

Çdo institucion propozues akti/tesh për miratim në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian duhet të kontrollojë përputhjen mes listës së akteve që do të përfshihen në këtë dokument me listën e akteve që ajo ka parashikuar për miratim në Programin e përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit të parë të zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian.

Zbatimi i “acquis”, planifikohet duke marrë në konsideratë dhe duke përcaktuar të paktën masa të tilla si:

- Krijimi/ristrukturimi i strukturave administrative me qëllim kryerjen e funksioneve të caktuara;

- Shtim burimesh njerëzore apo ri-shpërndarje funksionesh duke kalkuluar ngarkesën e punës sipas metodologjive të përcaktuara nga Departamenti i Administratës Publike;
- Trajnime për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë për të transpozuar dhe zbatuar “acquis”;
- Përmirësimi i strukturave/sistemeve/mjeteve/procedurave/metodave të mbështetura për zhvillimin/zbatimin, bashkëpunimin ndërinstitucional, transparencën, pjesëmarrjen e publikut etj.;
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve apo ofrimi i shërbimeve të reja;
- Burime teknike;
- Planifikim investimesh në infrastrukturën publike;
- Masa të planifikuara në kuadër të asistencës së para-aderimit (IPA) dhe donatorëve të tjerë.

Çdo masë zbatuese është e lidhur me një masë të BE -së dhe rrjedhimisht një masë legislative kombëtare që transponon masën e BE -së. Megjithatë, disa masa zbatuese (si trajnime që lidhen me nivelin e nën-titullit ose kapitullit, sistemet që përfshijnë mbështetje për zbatimin e më shumë se një mase) mund të lidhen me nivelin e nën-titullit ose kapitullit. Sidoqoftë, është e rëndësishme që këto masa të rrjedhin nga kërkesat e BE -së.

Afatet e përcaktuara në PKIE duhet të jenë realiste dhe të arritshme, bazuar në vlerësimin e kapaciteteve në dispozicion për të kryer funksionet e planifikuara, rritjen e ardhshme/të planifikuar të kapaciteteve dhe ndikimin e parashikuar socio-ekonomik.

- **Përcaktimi i Kostove**

Njësia teknike përgjegjëse për masën/nën-titullin bën parashikimet e kostove specifike në konsultim me njësinë përgjegjëse për financat dhe buxhetin në Ministrinë e linjës apo Institucionin shtetëror përkatës.

Njësia përgjegjëse për financat dhe buxhetin jep të dhëna për kostot e planifikuara /mbulimin e masave nga buxheti trevjeçar.

Njësia IPA në ministri apo institucionin shtetëror jep të dhëna për financimin e planifikuar për masat e mbështetura nga IPA dhe donatorë të tjerë.

Me qëllim përcaktimin e nevojës për planifikimin e burimeve financiare të nevojshme për zbatim e acquis (përfshirë masat zbatuese), mbledhet shuma totale e kostove të masave prioritare të projektuara për një vit dhe krahasohet me fondet e alokuara për ato masa. Hendeku i krijuar ndërmjet dy përlllogaritjeve shërben për programimin e burimeve të fondeve të nevojshme për vitet në vijim për periudhën e planifikuar.

Pas identifikimit të masave ligjore dhe zbatuese, ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera propozuese do të bashkëpunojnë ngushtë me Ministrinë përgjegjëse për Financën, përfshirë në kuadër të grupit respektiv ndërinstitucional të punës, për vlerësimin e hapësirës buxhetore për zbatimin e masave ligjore dhe zbatuese që janë në proces planifikimi. Ministrinë dhe

institucionet përgjegjëse për propozimin dhe realizimin e masës ligjore dhe zbatuese duhet të sigurojnë që financimi për këto masa të jetë i përfshirë në buxhetin për vitin pasardhës ose në programin buxhetor afatmesëm. Në asnjë rast, në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian nuk duhet të vendosen masa ligjore/zbatuese për të cilat mungon financimi për hartimin dhe zbatimin e tyre.

Duke konsideruar që PKIE shërben për të monitoruar dhe raportuar jo vetëm procesin e përafrimit të legjislacionit vendas me “acquis”, por edhe zbatimin e tij, është vecanërisht e rëndësishme që masat ligjore apo zbatuese duhet të plotësohen me masat në investime (punë apo blerje) të cilat mundësojnë këtë zbatim sipas rastit.

Hartimi dhe Kontrolli i Cilësisë

Pas përfundimit të fazës së planifikimit, grupi ndërinstitucional i punës për kapitullin respektiv, nëpërmjet institucionit lider të GNPIE-së, fillon hartimin e projektdokumentit të PKIE, për kapitullin ose kapitujt për të cilët është përgjegjës, duke respektuar strukturën e miratuar në këtë udhëzues. Dokumenti do të hartohet njëkohësisht në gjuhën shqipe dhe angleze.

Pas dakordësisë në GNPIE-të përkatëse, dokumenti për çdo kapitull dërgohet nga negociatori përgjegjës pranë Kryenegociatorit dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për shqyrtim paraprak. Shqyrtimi paraprak do të synojë kontrollin e saktësisë së informacionit të paraqitur në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian, duke marrë në konsideratë “Dokumentat dhe Burimet referuese” si dhe “Analizën e Mangësive” (Shiko Krerët përkatës). Vërejtjet e Kryenegociatorit dhe të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme duhet të reflektohen në dokument nga grupet ndërinstitucionale të punës, dhe dokumenti i rishikuar duhet të përcillet nga Negociatori i kapitullit për miratim përfundimtar në Grupin Negociator.

Stili i hartimit të PKIE duhet të jetë i qartë dhe i saktë. Kontributi i institucioneve duhet të fokusohet në masën prioritare të planifikuar në përputhje me përgjegjësisë përkatëse në miratimin dhe zbatimin e “acquis”, dhe jo në aktivitetet e saj individuale.

Sekretariati i GNPIE rishikon tekstin e kapitullit përkatës të PKIE dhe siguron uniformitetin e termave dhe gjuhës së përdorur në tërësinë e tij si dhe bën vlerësimin e parë të cilësisë së tij.

MEPJ përpilon dokumentin dhe kryen sigurimin e cilësisë në nivelin e të gjithë dokumentit për sa i përket strukturës dhe përmbajtjes dhe kryen një rishikim përfundimtar të draft dokumentit në përputhje me këtë Metodologji, si dhe korrigjimin në anglisht.

Paralelisht me procedurën e sigurimit të cilësisë, MEPJ siguron konsultime me Komisionin Evropian për projektdokumentin e PKIE.

Konsultimi dhe Miratimi

- Konsultimi me Aktoret Jo-shtetëror

Ministritë dhe institucionet lider të grupeve ndërinstitucionale të punës janë përgjegjëse për konsultimin e kapitujve përkatës në tryezat e partneritetit ngritur në përputhje me Ligjin nr.

146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, dhe Urdhrin e Kryeministrit Nr. 113, datë 30.8.2019, “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian”. Rezultatet e këtij konsultimi kihen parasysh gjatë finalizimit të kapitullit përkatës. Ministritë dhe institucionet lider të grupeve ndërinstitucionale të punës mbajnë procesverbal mbi takimet konsultuese në tryezat e partneritetit dhe rezultatet e këtij procesi. Procesverbali paraqitet pranë Kryenegociatorit dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, kjo e fundit si institucioni shtetëror përgjegjës për konsultimin publik të PKIE-së në tërësi, përpara miratimit final nga Këshilli i Ministrave.

Pas reflektimit të vërejtjeve dhe sugjerimeve të Kryenegociatorit dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe konsultimit në tryezat e partneritetit, GNPIE-të finalizojnë dokumentin për çdo kapitull në gjuhën shqipe dhe angleze njëkohësisht. Negociatori përgjegjës e përcjell dokumentin tek Kryenegociatori dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Ministritë dhe institucionet koordinuese janë përgjegjëse për saktësinë e përkthimit dhe njëjtësinë mes versionit në gjuhën shqipe dhe atij në gjuhën angleze.

- Miratimi

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian i paraqitet në tërësi për miratim Grupit Negociator.

Kryenegociatori ia paraqet Planin Kombëtar për Integrimin Evropian për miratim Bordit Drejtues të Platformës së Partneritetit. Vërejtje të mundshme i kthehen për plotësim grupeve ndërinstitucionale të punës. Pas plotësimit të tyre, Plani Kombëtar për Integrimin Evropian i kthehet për miratim Grupit Negociator.

Struktura përgjegjëse në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme mbështet teknikisht koordinimin e këtij procesi dhe hartimin e raporteve përkatëse mbi miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian dhe konsultimin e tij në Bordin Drejtues të Platformës së Partneritetit.

Sipas udhëzimeve të Kryenegociatorit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme përgatit paketën ligjore për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian dhe vepron në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 584, datë 28.8.2003, “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”, i ndryshuar.

- Konsultimi i projektakteve me shërbimet e Komisionit Evropian

Të gjitha ose disa nga aktet e përfshira në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian mund të përzgjidhen nga shërbimet e Komisionit Evropian për t’u konsultuar me ta përpara miratimit të tyre.

Gjatë zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, për akte të caktuara ligjore të planifikuara do të kërkohet konsultimi i tyre me shërbimet e Komisionit Evropian.

Lista e akteve që parashikohen për herë të parë në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian do t'i dërgohet shërbimeve të Komisionit Evropian për të vlerësuar nevojën për konsultim përpara miratimit të tyre.

Nëse në Planin e ri do të ketë masa ligjore të mbartura nga Plani paraardhës, për të cilat Komisioni Evropian ka kërkuar konsultim më herët apo masa ligjore, për të cilat Komisioni ka kërkuar konsultim gjatë mekanizmave të ndryshëm të MSA-së, kjo do të tregohet në tabelën e masave ligjore të propozuara.

Drejtorja e Përgjithshme e Fqinjësisë dhe Negociatave të Zgjerimit, në bashkëpunim me shërbimet kompetente të Komisionit Evropian përdor formatet e mëposhtme të konsultimit të projektakteve shqiptare:

- Projektakti kërkohe për konsultim nga shërbimet e Komisionit Evropian;
- Hartimi dhe finalizimi i projektaktit do të mbështetet me ekspertizë në kuadër të instrumentit TAIEX ose ndonjë instrumenti/projekti tjetër të financuar nga Bashkimi Evropian;
- Projektakti nuk ka nevojë që të konsultohet paraprakisht me shërbimet e Komisionit Evropian.

Procesi i konsultimit të projektakteve me Komisionin Evropian do të koordinohet nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, në konsultim me Kryenegociatorin.

Projektaktet ligjore shqiptare që do të përzgjidhen për konsultim me shërbimet e Komisionit Evropian duhet të jenë të finalizuara, të kenë kaluar fazën e konsultimit informal me ministrinë e linjës dhe atë të konsultimit publik, por përpara fillimit të procesit formal të marrjes së mendimeve të ministrive të linjës. Kjo për të shmangur një vlerësim të dytë të projektaktit nga shërbimet e Komisionit Evropian.

Paketa e plotë e konsultimit për çdo akt të veçantë duhet të përmbajë, të përkthyer në gjuhën angleze:

- tekstin e projektaktit;
- relacionin shoqërues të projektaktit duke përfshirë implikimet buxhetore, sikurse kërkuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 584, datë 28.8.2003, "Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave", i ndryshuar;
- tabelën e përputhshmërisë ku të tregohet qartë se cilat rregulla juridike të akteve të Bashkimit Evropian synohen të përafrohen;
- përmbledhjen e shkurtër mbi procesin e konsultimit publik, që tregon kohëzgjatjen e konsultimit publik, pjesëmarrjen e të interesuarve, dhe ndjekjen e mendimeve të tyre. Në rast se projektakti nuk është paraqitur për konsultim publik duhet të tregohet baza ligjore dhe arsyet për këtë;
- raportin mbi konsultimet me njësitë e qeverisjes vendore, nëse një konsultim i tillë është kryer;
- përmbledhjen në gjuhën angleze të vlerësimit të ndikimit rregullator, nëse ky vlerësim është kryer.

Nëse përafrimi i një akti të Bashkimit Evropian do të synohet të kryhet përmes dy ose më shumë projektakteve shqiptare, atëherë shërbimet e Komisionit Evropian preferojnë dërgimin e këtyre projektakteve në një paketë të vetme. Në një rast të tillë, kërkohet që të hartohet një tabelë përputhshmërie e aktit të Bashkimit Evropian me të gjithë projektaktet shqiptare që synojnë përafrimin e tij.

Monitorimi, Raportimi dhe Vlerësimi

Zbatimi i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian është përgjegjësi e ministrisë apo institucionit që ka propozuar masën ligjore për miratim ose masën zbatuese dhe Negociatorit/Kryetarit të GNP-së, nën kapitullin negociues të të cilit është bërë planifikimi.

Në bazë të Urdhrit të KM nr. 94, datë 20.05.2019, grupet ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian, janë përgjegjëse për bashkërendimin e hartimit dhe përditësimit të kapitullit përkatës të PKIE. Për këtë arsye, hartimi i projektakteve dhe monitorimi i procesit të finalizimit të tyre me procedura miratuese duhet të bëhet në konsultim të vazhdueshëm me ministrinë/ institucionin koordinues lider dhe anëtarët e tjerë të grupit ndërinstitucional të punës.

- Monitorimi

Kryenegociatori, Komitetit teknik me udhëzimin e tij dhe struktura koordinuese në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme monitoron zbatimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian.

Monitorimi kryhet në dy nivele: në nivelin e kritereve/kapitujve dhe në nivelin e ministrisë/institucionit përgjegjës.

Ministria apo institucioni shtetëror të cilit i është caktuar përgjegjësia për masën kombëtare ka përgjegjësinë për përditësimin e statusit të tij. Njësia e BE -së në institucionin përkatës/personi përgjegjës në institucionet që nuk kanë njësi të BE -së përditëson statusin e masës menjëherë pas ndryshimit të statusit, bazuar në informacionin e marrë nga njësia teknike përgjegjëse.

Njësia e BE -së në ministri/institucion monitoron rregullisht statusin e masave për të cilat Ministria/institucioni është përgjegjës mbështetur në informacionin e marrë nga sektorët teknike përgjegjës. Një herë në muaj njësia e BE -së i paraqet (në formë matricë) raportin e monitorimit Negociatorit të GNPIE përkatës. Sekretariatet e GNPIE diskutojnë raportet mujore të monitorimit (matrica) dhe propozojnë masa për të adresuar vonesat.

Në nivel të PKIE, monitorimi kryhet bazuar në raportimet mujore të ardhura nga ministrinë dhe institucionet lider për grupet ndërinstitucionale të punës. Raportimet mujore do të tregojnë aktet ligjore të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, aktet ligjore të pamiratuara brenda afatit të përcaktuar në PKIE, masat zbatuese të realizuara dhe ato të porealizuara brenda afatit, si dhe problematikat e ndeshura.

MEPJ prodhon një raport monitorimi mujor dhe informon Kryenegociatorin për statusin e zbatimit, duke propozuar masat përkatëse për të adresuar vonesat e mundshme.

- **Raportimi**

Mbështetur në procesin e monitorimit, struktura koordinuese në MEPJ harton raportet mujore dhe tremujore. Raportet e monitorimit të realizimit të PKIE-së janë një indikator për përfundimin e ndihmës sektoriale buxhetore për reformën e administratës publike, dhe gjithashtu bëhen pjesë e raportimeve tremujore në bazë kapitulli të negociatorëve drejt kryenegociatorit dhe të Kryenegociatorit drejt Këshillit të Ministrave, si dhe për raportet periodike për Kuvendin e Shqipërisë, bazuar në Ligjin nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.

Në fillim të çdo viti, Kryenegociatori udhëzon strukturën koordinuese të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të hartojë draft raportin vjetor të zbatimit të PKIE për vitin paraardhës, i cili finalizohet në Grupin Negociator.

Raportet tremujore mund të diskutohen në takimet e tryezave të platformës së partneritetit. Raportet vjetore mund të diskutohen në takimin e Bordit Drejtues të Platformës së Partneritetit për integritetin evropian.

- **Vlerësimi**

MEPJ kryen një vlerësim të procesit të zbatimit të PKIE një herë në vit, pas mbylljes së ciklit vjetor të planit.

Vlerësimi kryhet nga një grup pune i posaçëm i formuar nga MEPJ, me pjesëmarrjen e sekretariatit të secilit GNPIE. Vlerësimi mund të kryhet edhe nga vlerësues të jashtëm të kontraktuar nga MEPJ ose Kryenegociatori.

Struktura e përgjithshme e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian është strukturuar sipas Kritereve të Kopenhagenit për anëtarësimin. Në vijim të praktikës së mëparshme, struktura e pjesës mbi Aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit pasqyron strukturën e kapitujve negociues dhe *acquis* përkatëse.

PKIE përbëhet nga këto pjesë kryesore:

1. Hyrje
2. Kriteri politik
3. Kriteri ekonomik
4. Aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit në BE
 - 4.1 Pjesa narrative
 - 4.2 Tabela e dokumenteve strategjike
 - 4.3 Tabelat e përafrimit të legjislacionit
 - 4.4 Tabela e masave zbatuese
 - 4.5 Tabelat e kostimit

Hyrja

Hyrja jep një vështrim të përgjithshëm të marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian; parashtron objektivat, strukturën dhe metodologjinë për përgatitjen e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian.

Hyrja përgatitet nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Hyrja duhet të përmbajë elementet e mëposhtëm:

1. Hyrja
 - 1.1 Vështrim i përgjithshëm i marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian
 - 1.2 Objektivat e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian
 - 1.3 Struktura e PKIE
 - 1.4 Metodologjia e hartimit të PKIE
 - 1.5 Monitorimi i zbatimit të PKIE

Kriteri politik

Pjesa e Kriteri politik jep një pamje të përgjithshme të ecurisë së Shqipërisë në raport me kriterin e parë të Kopenhagenit, duke u fokusuar tek stabiliteti i institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës dhe respektimin e të drejtave të njeriut e të minoriteteve.

Pjesa e Kriterit politik hartohet nga Ministria e Drejtësisë. Kjo pjesë nuk ka përaftrim legjislativ dhe është një përmbledhje analitike e raportimeve të bëra nga Shqipëria për këtë kapitull.

Gjatë hartimit të këtij Kapitulli duhet të bëhet një paraqitje sa më e plotë e arritjeve në plotësimin e rekomandimeve kyçe të Këshillit në lidhje me reformën në drejtësi dhe luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Kjo pjesë përfshin nënkapitujt e mëposhtëm:

2. Kriteri politik

2.1 Demokracia dhe shteti i së drejtës

2.1.1 Kuvendi

2.1.2 Zgjedhjet

2.1.3 Qeverisja

2.1.4 Reforma në administratën publike

2.1.5 Sistemi gjyqësor dhe reforma në sistemin e drejtësisë

2.1.6 Anti-korrupsioni

2.2 Të drejtat e njeriut

2.3 Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare

2.3.1 Bashkëpunimi rajonal

2.2.1 Marrëdhëniet Bashkimi Evropian – Shqipëri

Pjesa e Kriterit ekonomik përqendrohet në zhvillimet ekonomike dhe progresin në krijimin e një ekonomie tregu funksionale dhe të aftë të përballojë presionet konkurruese brenda Bashkimit Evropian. Kjo pjesë nuk ka *acquis* për të përafuar.

Pjesa e Kriterit ekonomik hartohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Në këtë pjesë raportohet për politikat dhe reformat strukturore të cilat synojnë rritjen ekonomike, rritjen e punësimit, uljen e nivelit të borxhit, reduktimin e kredive të këqija, lehtësimin e procedurave të të bërit biznes, inkurajimin e përdorimit të monedhës vendase, zhvillimin e tregut të shërbimeve financiare, funksionimin e tregut të punës, rritjen e eksporteve vendase.

Në këtë kapitull, jepen shkurtimisht edhe objektivat kryesore dhe masat e përfshira në Programin e Reformave Ekonomike.

Kjo pjesë përfshin nënkapitujt e mëposhtëm:

3. Kriteri ekonomik

3.1 Funksionimi i ekonomisë së tregut

- 3.2.1 Zhvillimet ekonomike
- 3.2.2 Politikat monetare dhe fiskale
- 3.2.3 Ndërveprimi i forcave të tregut
- 3.2.4 Hyrja dhe dalja nga tregu
- 3.2.5 Sistemi ligjor (të drejtat e pronësisë; zbatimi i ligjit dhe i kontratave; efektshmëria e gjyqësorit
- 3.2.6 Sektori financiar

3.2 Kapacitetet për të përballuar presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian

- 3.2.1 Kapitali njerëzor dhe kapitali fizik
- 3.2.2 Struktura sektoriale dhe ajo e ndërmarrjeve
- 3.3.3 Ndikimi i shtetit në konkurrueshmëri/ konkurrencë
- 3.3.4 Integrimi tregtar

Aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit në BE

Kjo pjesë lidhur me aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit në BE, trajton të gjitha pjesët e *acquis* siç parashtrihen në traktate, legjislacionin dytësor, jurisprudencën gjyqësore dhe politikat e Bashkimit Evropian.

Kjo pjesë ndahet në 33 kapituj që përkojnë me kapitujt e negociatave të *acquis*. Për momentin, këtu nuk do të përfshihet Kapitujt negociues 34 dhe 35 Shumica e kapitujve ndahen në nënkapituj (që në disa raste ndahen në seksione). Struktura e kësaj pjese do të shërbejë si bazë për monitorimin dhe raportimin periodik për progresin e bërë dhe përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga MSA, si dhe për negociatat e ardhshme të anëtarësimit.

Në këtë pjesë jepet një përshkrim i kapitullit negociues, një vlerësim i përmbledhur i situatës, arrijtet kryesore të vitit 2020, institucionet e përfshira në grupin ndërinstytucional të punës të kapitullit, rekomandimet kryesore të palës evropiane për kapitullin, etj.

Kjo pjesë do të ndahet në këta kapituj:

- 4.1 Lëvizja e lirë e mallrave
- 4.2 Liria e lëvizjes së punëtorëve
- 4.3 E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime
- 4.4 Lëvizja e lirë e kapitalit
- 4.5 Prokurimi publik
- 4.6 E drejta e shoqërive tregtare
- 4.7 E drejta e pronësisë intelektuale
- 4.8 Politika e konkurrencës
- 4.9 Shërbimet financiare
- 4.10 Shoqëria e informacionit dhe media
- 4.11 Bujqësia dhe zhvillimi rural

- 4.12 Siguria ushqimore, politika veterinare dhe fitosanitare
- 4.13 Peshkimi
- 4.14 Politika e transportit
- 4.15 Energjia
- 4.16 Tatimet
- 4.17 Politika ekonomike dhe monetare
- 4.18 Statistikat
- 4.19 Politikat sociale dhe punësimi
- 4.20 Ndërmarrjet dhe politikat industriale
- 4.21 Rrjetet trans-evropiane
- 4.22 Politika rajonale dhe bashkërendimi i instrumenteve strukturore
- 4.23 Gjyqësori dhe të drejtat themelore
- 4.24 Drejtësia, liria dhe siguria
- 4.25 Shkenca dhe kërkimi shkencor
- 4.26 Arsimi dhe kultura
- 4.27 Mjedisi
- 4.28 Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit
- 4.29 Bashkimi doganor
- 4.30 Marrëdhëniet me jashtë
- 4.31 Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes
- 4.32 Kontrolli financiar
- 4.33 Dispozita financiare dhe buxhetore

Struktura e pjesës narrative të kapitujve negociues

Pjesa narrative për secilin nga 33 kapitujt e listuar më sipër do të strukturohet si vijon:

*X. TITULLI I KAPITULLIT*²

4.X.1.1 PËRMBAJTJA E KAPITULLIT

Këtu do të jepet një paragraf i shkurtër duke treguar fushën e veprimit dhe qëllimet e *acquis* së kapitullit. Mund të vendosni këtu tekstin e të njëjtit paragraf nga PKIE e mëparshme, i cili duhet të bazohet në prioritetet e legjislacionit të kapitullit, sipas shpjegimeve në takimet shpjeguese të *acquis* dhe në pjesën hyrëse të kapitullit në Raportin më të fundit të Komisionit Evropian për Shqipërinë që përmban vlerësimin e progresit faktik për një periudhë njëvjeçare. Duhet të fokusoheni në ndryshimet tek *acquis* në fusha specifike nëse ka të tilla.

4.X.1.2 STRUKTURA E KAPITULLIT

Këtu në rastin e kapitujve të ndarë në nënkapituj do të jepet lista e nënkapitujve. Në rast se kapitulli nuk është i ndarë në nënkapituj shtoni një fjali për këtë. Të mos hiqet kjo pikë e pjesës narrative në mënyrë që të mos ndryshojë numërimi i nënkapitujve.

4.X.1.3 PËRMBLEDHJE E KËRKESAVE TË MSA-SË DHE ACQUIS SË BASHKIMIT EVROPIAN

Këtu duhet të tregohen nenet përkatëse të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit që përcaktojnë detyrimet dhe prioritetet në kapitullin në fjalë, si dhe kërkesat kryesore të *acquis* së Bashkimit Evropian. Në kërkesat kryesore të *acquis* së Bashkimit Evropian, ministrinë dhe institucionet mund të mbështeten në informacionin që kanë marrë gjatë takimeve shpjeguese. Ky informacion duhet të përditësohet nga versioni i mëparshëm, nëse ka të tilla.

4.X.1.4 SITUATA AKTUALE NË SHQIPËRI DHE ARRITJET KRYESORE

Në këtë pjesë, për çdo kapitull/ nënkapitull (për kapitujt e ndarë në nënkapituj) duhet të jepet me një – dy paragrafë situata aktuale në kapitull/ nënkapitull. Të mbahen parasysh edhe vlerësimet e Komisionit Evropian të bëra në Raportin më të fundit të Komisionit Evropian për Shqipërinë. Gjithsesi, informacioni i dhënë si input nga pala Shqiptare gjatë vlerësimit të Komisionit Evropian nuk duhet të përsëritet. Gjithashtu në këtë pjesë duhet të jepen me pika arritjet kryesore gjatë periudhës së mëparshme të raportimit (viti para rendës).

4.X.1.5 LISTA E MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE

Këtu duhet të jepet lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse duke filluar me ministrinë/ institucionin koordinues të grupit ndërinstitucional të punës. Lista e ministrive dhe institucioneve duhet të bazohet në Urdhrin e Kryeministrit Nr. 94, datë 20.5.2019, “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian”. Në hartimin e kësaj liste duhet të mbahet parasysh edhe lista e ministrive dhe

² Me X shënohet numri i kapitullit.

institucioneve publike e identifikuar gjatë përgatitjeve për takimet bilaterale. Përditësimi i këtij informacioni është i nevojshëm.

4.X.1.6 MANGËSITË E IDENTIFIKUARA DHE PRIORITET

Në këtë pjesë, për secilin kapitull/nënkapitull (për kapitujt e ndarë në nënkapituj) një vlerësim i arritjeve aktuale dhe hendekut midis situatës së dëshiruar dhe situatës aktuale duhet të sigurohet në masën e mundshme. Situata e dëshiruar është ajo e gatishmërisë së plotë për pranimin në BE në një fushë të caktuar që përfshin miratimin e plotë të acquis, krijimin e strukturave të nevojshme administrative dhe kushte të tjera të anëtarësimit. Zakonisht ky hendek krijohet si rezultat i shqyrtimit dypalësh. Mund të bëhet në terma të përgjithshëm para se të përdorni vlerësimet vjetore të KE -së për progresin e Shqipërisë, materialet e explanatoring screening, informacione të tjera analitike, përfshirë informacionin e siguruar nga projektet e asistencës teknike.

Këtu duhet të tregohen prioritetet kryesore të kapitullit duke u bazuar në rekomandimet afatshkurtra të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, në rekomandimet e Nënkomitetit të fundit të Stabilizim Asociimit, ku përfshihet kapitulli, si dhe në rekomandimet e Komitetit më të fundit të Stabilizim-Asociimit.

Këtu duhet të tregohen përparësitë kryesore të kapitullit bazuar në rekomandimet afatshkurtra të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, rekomandimet e Nënkomitetit të fundit të Stabilizim Asociimit, përfshirë kapitullin, si dhe rekomandimet e Komitetit të fundit të Stabilizim Asociimit. Për shembull, mbulimi i bujqësisë është i detajuar dhe siguron një pasqyrë të mirë të prioritetëve siç shihen nga BE. Përparësi i jepet disa parakushteve bazë për një harmonizim efektiv të ligjit, siç është krijimi i të drejtave pronësore në bujqësi dhe regjistrimi i duhur i të gjitha llojeve të kapitalit, të tilla si toka dhe kafshët. Mungesa e regjistrimit duket si pengesa kryesore gjithashtu për të ofruar ndihmë zhvillimore për fermat përmes skemave të përkrahura të mbështetjes nga BE.

Duhet të pasqyrohen qartësisht prioritetet e brendshme që burojnë nga dokumentet e politikave strategjike, strategjitë sektoriale në veçanti, dhe prioritetet sektoriale duhet të lidhen me prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe Programit Qeveritar.

Sectoral priorities should be linked with priorities of the National Strategy for Development and Integration and the Government Program.

Udhëzuesit e zhvilluar për ndikimet institucionale të harmonizimit të ligjit, siç është Udhëzuesi për Strukturat Administrative Kryesore të Kërkuara nga Acquis do të jenë të disponueshëm sipas kërkesës.

Shumë standarde të përcaktuara nga BE shtrihen përtej acquis dhe lidhen me funksionet thelbësore të shtetit, të tilla si funksionimi i demokracisë dhe tregut, sundimi i ligjit dhe institucionet e tjera. Kjo qëndron edhe për udhëzuesin mbi strukturat administrative. Për taksimin, për shembull, BE -ja me të drejtë nuk është e shqetësuar për një acquis të detajuar, por për kapacitetin e shtetit për të rritur taksat. Në politikën sociale, kushtet e BE -së nuk kanë të bëjnë aq shumë me acquis të drejtpërdrejta që lidhen me koordinimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore, por, me të drejtë, me trendet e punësimit, kapacitetet e zyrave të punësimit për t'u trajnuar dhe kapacitetet e inspektoratit të punës për t'u marrë me një ekonomi

joformale. Udhëzues sektorialë, veçanërisht në sektorët më kompleksë, siç është mjedisi³ mund të sigurohen nga projektet e asistencës teknike.

Acquis në fushat e bujqësisë, energjisë, transportit dhe mjedisit është shumë gjithëpërfshirëse. Në fushën e energjisë, fushëveprimi i harmonizimit dhe logjika e tij sektoriale përcaktohet nga fushëveprimi i Komunitetit Evropian të Energjisë, i cili përfshin një pjesë të konsiderueshme të legjislacionit të BE -së për energjinë dhe një pjesë të rëndësishme të acquis të mjedisit gjithashtu.⁴ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë Evropiane ka zhvilluar një numër udhëzimesh mbi aspekte të ndryshme të acquis në fushën përkatëse të energjisë, të cilat mund të përdoren në procesin e caktimit të prioriteteve. Në fushën e transportit, acquis përfshin legjislacionin për transportin rrugor, detar dhe hekurudhor, dhe është veçanërisht gjithëpërfshirës në zonën e transportit ajror. Paralelisht me energjinë, Komuniteti i Transportit⁵ gjithashtu shërben si një qendër e njohurive dhe udhëzimeve të grumbulluara në këtë sektor për vendet aderuese.

TABELA E DOKUMENTEVE STRATEGJIKE PËR TU MIRATUAR

Tabela e dokumenteve strategjike do të hartohet nga ministritë e linjës sipas formatit të përcaktuar në tabelën Excel bashkëlidhur.

Në kolonën e parë dhe të dytë duhet të plotësohet numri dhe titulli i kapitullit dhe titulli i nënkapitullit. Kolona e tretë nuk është e nevojshme të plotësohet në rastin e dokumenteve strategjike sepse këto nuk përafrojnë akte ligjore të Bashkimit Evropian. Kolona e katërt duhet të plotësohet me titullin e strategjisë apo dokumentit strategjik shqiptar që synohet të miratohet. Kolona e llojit të aktit të përafroar duhet të plotësohet duke treguar nëse strategjia apo dokumenti strategjik do të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, urdhër ministri, etj. Kolona përcaktuese e dokumentit të konsultuar duhet plotësuar duke treguar nëse strategjia ose dokumenti strategjik do të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me urdhër të ministrit, etj. Kolona e dokumentit strategjik do të shërbejë për të filtruar dokumentet strategjike nga aktet ligjore që synojnë përafrim. Në rastin e dokumenteve strategjike duhet të plotësohet me PO. Në kolonën e institucionit propozues, duhet të vendoset akronimi i ministrisë/ institucionit propozues. Kolona e përafrimit, nuk është e nevojshme të plotësohet në rastin e dokumenteve strategjike. Dy kolonat e fundit plotësohen duke treguar vitin e miratimit (2021, 2022 apo 2023) dhe tremujorin e miratimit (I, II, III, IV)).

TABELA E AKTEVE LIGJORE PËR T'U MIRATUAR

Në këtë tabelë Excel duhet të plotësohen të gjitha kolonat.

Në rast se i njëjti akt i Bashkimit Evropian përafrohet nga dy akte të veçanta shqiptare, të përfshira në këtë Plan, atëherë, duhet të plotësohen dy rreshta të veçanta, secili me aktin e veçantë shqiptar.

³ <https://ec.europa.eu/environment/archives/guide/part1.htm>, shikuar më 11 maj 2021. Kërkimi në Google mbi udhëzuesin e harmonizimit të ligjit të BE -së të bërë në të njëjtën ditë tregon qartë vetëm këtë udhëzues të vetëm sektorial.

⁴ Acquis e KEE përfshin 40 akte ligjore dhe dy rekomandime në fushën e ndryshimit të klimës. <https://ec.europa.eu/energy-community/legal/acquis.html> aksesuar më 18 maj, 2018.

⁵ <https://ec.europa.eu/transport-community.org/>

Në rast se i njëjti akt shqiptar përafuron dy ose më shumë akte të Bashkimit Evropian, atëherë këto akte përfshihen në të njëjtën qelizë, duke pasur vetëm një rresht për çdo akt të veçantë shqiptar që do të propozohet për miratim.

Ministritë dhe institucionet koordinuese duhet të bëjnë kujdes në rastin e përfshirjes së të njëjtit akt shqiptar në 2 kapituj ose nënkapituj të ndryshëm, për të evituar rritjen artificiale të numrit të projektakteve shqiptare të propozuara.

Në tabelën e planifikimit të akteve ligjore janë shtuar 3 kolona të reja. Kolona K, kërkon informacion nëse akti është kërkuar për konsultim nga shërbimet e Komisionit Evropian. Nëse është kërkuar do të vendoset një PO. Nëse akti është kërkuar për konsultim (Kolona K është plotësuar me PO), atëherë ministritë dhe institucionet do të plotësojnë edhe kolonën L, me formën e konsultimit.

Këto kolona do të plotësohen bazuar në informacionin e marrë nga shërbimet e Komisionit Evropian për aktet që ata duan të konsultojnë dhe formën e konsultimit për Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2020 – 2022.

Për aktet e parashikuara në PKIE 2020 – 2022 për të cilat shërbimet e Komisionit nuk kanë kërkuar të konsultohen, kolona K do të plotësohet me JO.

Për aktet të cilat përfshihen për herë të parë në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian, kjo kolonë nuk do të plotësohet.

Kolona M tregon nëse kërkohet përkthimi i aktit të Bashkimit Evropian nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, në kuadër të procesit të përafrimit. Nëse përkthimi i aktit të Bashkimit Evropian nuk kërkohet, atëherë duhet të shënoni JO. Nëse kërkohet përkthimi i aktit të Bashkimit Evropian, atëherë, kjo kolonë duhet plotësuar me PO. Në çdo rast, duhet të mbahet parasysh se përkthimi i akteve të Bashkimit Evropian kryhet sipas procedurave të prokurimit publik dhe këto procedura mund të zgjasin afërsisht një vit. Në vitin 2022 do të përkthehen aktet që do të përafrohen gjatë vitit 2023.

TABELA E MASAVE ZBATUESE

Masa zbatuese do të konsiderohen ato aktivitete që synojnë në përgjithësi plotësimin e kriterëve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe veçanërisht ato që lidhen me zbatimin e legjislacionit të përafuar, si dhe plotësimin e rekomandimeve të shërbimeve të Komisionit Evropian. Masa zbatuese konsiderohen përkthimi i legjislacionit, trajnime, shtesa personeli në ministritë apo institucionet ekzistuese, ngritja e institucioneve të reja, forcimi i përgjithshëm i kapaciteteve administrative, investime në infrastrukturë, logjistikë, etj. Disa nga këto masa gjenden të listuara në relacionin bashkangjitur draft ligjit dhe Raportin e Vlerësimit të ndikimit. Nëse këto masa implementimi nuk janë të qarta është e mundur të planifikosh përgatitjen e planit zbatues të aktit ligjor në fjalë, sidomos nëse është mjaftueshëm i rëndësishme.

Angazhimet institucional për adoptimin e akteve ligjore mund të kontrollohen sipas udhëzuesit të listuar më sipër për Strukturën Kryesore Administrative të kërkuar nga Acquis. Investimet janë sidomos të rëndësishme duke qënë se kërkojnë burime të mëdha dhe janë kritike në zbatim.

Tabela e masave zbatuese do të hartohet nga ministritë e linjës sipas formatit të përcaktuar në tabelën Excel.

Në këtë tabelë duhet të vendosen vetëm ato masa zbatuese që janë të financuara plotësisht nga buxheti i shtetit ose nga donatorët e huaj. Propozime për nevoja të rëndësishme por të pa buxhetuata për 2023-2024 mund të listohen dhe nënvizohen specifikisht..

ALOKIMET FINANCIARE

Alokimet financiare do të llogariten më vete, në Lekë, për çdo masë ligjore/dokument strategjik/masë zbatuese.

Për çdo akt ligjor/ dokument strategjik të veçantë do të parashikohen:

- kostot për hartimin e aktit;
- kostot për zbatimin e aktit ligjor/ dokumentit strategjik.

Kostot për hartimin e aktit do të përfshijnë kryesisht:

- pagat, sigurimet shoqërore dhe çdo shpërblim tjetër për punonjësit e administratës publike të angazhuar drejtpërsëdrejti në hartimin e aktit, duke përfshirë përkthimin e aktit të Bashkimit Evropian, hartimin e aktit shqiptar, përgatitjen e projektaktit për miratim, përfshirë hartimin e tabelave të përputhshmërisë;
- shpenzime operative, duke përfshirë një vlerësim të shpenzimeve për mjedise pune, energji elektrike, ujë, pastrim, shpenzime udhëtimi, konsulencë, etj

Kostot për zbatimin e aktit ligjor/ dokumentit strategjik përfshijnë kryesisht:

- pagat, sigurimet shoqërore dhe çdo shpërblim tjetër për punonjësit ekzistues të administratës publike të angazhuar drejtpërsëdrejti në zbatimin e aktit, duke përfshirë, planifikimin, zbatimin, monitorimin, raportimin, etj.;
- pagat, sigurimet shoqërore dhe çdo shpërblim tjetër për punonjësit e rinj të administratës publike, si në institucione ekzistuese ashtu edhe në institucione që do të ngrihen të reja, të angazhuar drejtpërsëdrejti në zbatimin e aktit, duke përfshirë, planifikimin, zbatimin, monitorimin, raportimin, etj.;
- shpenzime operative, duke përfshirë një vlerësim të shpenzimeve për mjedise pune, energji elektrike, ujë, pastrim, shpenzime udhëtimi, konsulencë, etj., për punonjësit ekzistues ose të rinj të institucioneve ekzistuese ose të reja;
- investime (shpenzime kapitale) që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e aktit ligjor ose dokumentit strategjik, duke përfshirë kostot e lidhura me projektet e parafizibilitetit, fizibilitetit, studimet, përgatitja dhe zhvillimi i prokurimeve, ndërtimet, rikonstruktionet, etj.

Për vetë natyrën e tyre, kostot e zbatimit të akteve janë shumë herë më të mëdha se ato për hartimin e tyre.

Investimet duhet të identifikohen qartë duke i lidhur ato me parashikimet në programin buxhetor afatmesëm dhe buxhetin e vitit të parë të zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore duhet të sigurojnë përputhshmërinë ndërmjet këtyre dokumenteve. Projektet e investimeve janë të paraqitura më vete dhe plotësisht të kostuar në programin buxhetor afatmesëm, duke lejuar edhe një planifikim në periudhën trevjeçare që përputhet me periudhën e zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian.

Në lidhje me kostot për zbatimin e legjisllacionit duhet të mbahen parasysh vlerësimet e ndikimit rregullator. Vlerësimi i ndikimit rregullator do të përdoret gjithnjë e më tepër, nëpërmjet rritjes së numrit të këtyre vlerësimeve dhe cilësisë së tyre. Kjo do të arrihet si rrjedhojë e udhëheqjes metodologjike, trajnimeve, rritjes së eksperiencës, etj.

Më tej, kostot duhet të ndahen sipas burimit të tyre, duke pasqyruar më vete kostot që do të mbulohen nga buxheti i shtetit dhe ato që do të mbulohen nga donatorët, nëse janë të qarta.

Në kostot që mbulohen nga buxheti i shtetit duhet të përfshihen kostot e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore, kostot e institucioneve të varësisë së tyre, si dhe një vlerësim i kostove të njërive të qeverisjes vendore, për aq sa këto janë të përfshira në zbatimin e legjisllacionit të përafuar.

Kostot që mbulohen nga buxheti i shtetit do të vlerësohen me përafërsi bazuar mbi numrin e punonjësve që do të angazhohen në hartimin e projektaktit, numri i ditëve të punës të dedikuara që secili prej tyre do të punojë në hartimin e projektaktit dhe pagën bruto për ditë pune të tyre. Kosto standarde për njësi do të përdoren aty ku është e mundur.

Kostot që do të mbulohen nga donatorët e huaj për hartimin e projektaktit do të llogariten në bashkëpunim me projektet e asistencës së huaj.

Për çdo masë zbatuese të veçantë duhet të parashikohen kostot e zbatimit, të kategorizuara në kosto që mbulohen nga buxheti i shtetit apo fondet e vetë institucionit dhe ato që mbulohen nga donatorët.

Kostot do të paraqiten sipas tabelës Excel bashkëlidhur dhe do të mblidhen dhe përpunohen nga ministria/ institucioni koordinues për grupin ndërinstitucional të punës.

Përlllogaritja e koston (udhëzime)

Në llogaritjen e koston për pagën dhe sigurimet shoqërore për punonjësit duhet të kihet parasysh se INSTAT përlllogarit (tremujori i katërt i vitit 2019) se paga mesatare vjetore është rreth 766 000 Lekë. Paga mesatare mujore e një punonjësi në sektorin publik është 63 826 Lekë. Eventualisht, ministritë dhe institucionet mund të bëjnë një vlerësim të tyre të pavarur në lidhje me koston për paga dhe sigurime shoqërore. Së pari, sepse ka institucione publike që kanë një strukturë tjetër pagash (Banka e Shqipërisë, etj.). Së dyti, kostoja mund të ndryshojë në varësi të kualifikimit dhe pozicionit menaxherial e rrjedhimisht me paga mbi mesataren të punonjësit/sve që përfshihen në hartimin e një projektakti.

Në përlogaritjen e shpenzimeve të projekteve të huaja, duhet të kihet parasysh se si rregull, për hartimin e një projektligji kërkohen 50 – 70 ditë pune nga ekspertët e projekteve të asistencës së huaj. Për hartimin e një projektvendimi të Këshillit të Ministrave apo urdhri/udhëzimi të ministrit kërkohen mesatarisht 20 – 25 ditë pune. Për përgatitjen e strategjive ose dokumenteve strategjike kërkohet zakonisht një kohë më e gjatë, e cila duhet të vlerësohet rast pas rasti. Një ditë pune e një eksperti të huaj (*senior expert*) llogaritet në rreth 900 euro për ditë pune, ndërsa një ekspert shqiptar (*junior expert*) vlerësohet me rreth 450 – 500 euro për ditë pune.

Në llogaritjen e shpenzimeve korrente për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit, duhet të kihet parasysh diferencat mes shpenzimeve korrente për një punonjës ekzistues dhe për një punonjës të ri që shtohet në një institucion ekzistues, dhe më tej, në ngritjen e një institucioni të ri. Shpenzimet korrente janë shumë më të mëdha për marrjen në punë të një punonjësi të ri (shesë) sepse duhet të bëhet pajisja e plotë e tij me bazë materiale (tavolinë pune, kompjuter, pajisje zyre, etj.). Shpenzimet korrente mund të përlogariten me ndihmën e drejtorive të buxhetit dhe të njësive të prokurimit.

Për investimet është e vështirë që të jepen udhëzime në lidhje me kostimin e tyre. Kjo sepse projektet e investimeve janë shumë të ndryshëm njëri nga tjetri duke kërkuar edhe financime të ndryshme. Megjithatë, sikurse shpjeguar më sipër, për investimet duhet të përdoren parashikimet në programin buxhetor afatmesëm dhe buxhetin e vitit. Gjithashtu duhet të merren parasysh informacione të tjera nga dokumenta sektoriale, studime fizibiliteti, apo RIA.